

BREAKING NEWS

“KUFOMAT NUK DO TË VARROSEN MË, POR DO TË DIGJEN”/ ZYRTARI I LARTË BËN DENONCIMII



AKTUALITET


Plagoset ushtaraku në Vaun e Dejës, në kërkim kushëriri

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
21 MAJ 2017




Një 23- vjeçar është qëlluar me armë zjarri mbrëmjen e djeshme tek "Vau i Dejës", ndërsa në kërkim është shpallur edhe një 20-vjeçar si autor i dyshuar i plagosjes. Burime zyrtare policor bëjnë me dije se, i plagosur ka mbetur shtetasi Emiljano Zefi, 23 vjeç, ushtarak në Repartin Ushtarak, Vau i Dejës. Mësohet se 23- vjeçari Zefi është qëlluar në këmbë, dhe është dërguar menjëherë në spitalin rajonal të Shkodrës për të marrë ndihmën e parë mjekësore. Por pas kësaj, Zefi është transportuar me urgjencë drejt Spitalit të Traumës në kryeqytet për ndihmë më të specializuar, pasi plumbi i ka kapur arterien kryesore dhe për momentin raportohet se gjendja është stabilizuar. Ndërkohë burime pranë uniformave blu bëjnë me dije se autor i plagosjes ka qenë kushëriri i tij Pashk Gjoni, 20 vjeç. Nuk dihen ende motivet e kësaj ngjarje, ndërsa policia pasi ka shkuar në vendngjarje po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të saj. Nga ana tjetër janë ngritur pika të shumta kontrolli nga policia për të bërë të mundur arrestimin e autorit të dyshuar. “Në Vaun e Dejës me datë 20.05.2017, rreth orës 20:30 njoftohemi se ka ndodhur një plagosje me armë zjarri ku ka mbetur i plagosur shtetasi Emiljano Zefi, 23 vjeç, banues në Vaun e Dejës, me detyrë ushtarak pranë repartit ushtarak në Vau i Dejës, i cili po dërgohet në spitalin e Traumës Tiranë për trajtim më të specializuar. Menjëherë kanë mbërritur në vendngjarje shërbimet e Policisë ku sipas deklarimeve të para të marra në vendngjarje, dyshohet se autor i kësaj ngjarje është shtetasi Pash Gjoni, 20 vjeç, banues në Vau i Dejës. Nga ana jonë u bë shpallja në kërkim dhe po punohet për kapjen e tij. Janë ngritur pika kontrolli dhe vijon krehja e zonës me qëllim kapjen e autorit, si dhe grupi hetimor po vijon punën për zbardhjen e plotë të ngjarjes”, mbyllet njoftimi zyrtar i policisë së Shkodrës.


Më të lexuarat




“Sot pasdite rriten temperaturat”, meteorologia Adiola Bani zbulon si parashikohet të jetë moti gjatë kësaj jave dhe surprizat që na presin në muajin nëntor




Vrau ish-të dashurën dhe partnerin e saj teksa i kapi duke kryer marrëdhënie intime, kush është shqiptari që po kërkohet nga policia (FOTO)




U tha të ndërprisnin grevën e të uleshin në bisedime/ Reagojnë naftëtarët e Ballshit, ‘ultimatum’ kryeministrit Rama: Eja këtu dhe na jep...




“Në fillim nuk kam besuar këtë virus”, këngëtari i njohur shqiptar rrëfen eksperiencën me COVID-19: Infektova vëllezërit dhe përfundova në...




Gazetari i njohur shqiptar u sulmua me armë zjarri, reagon policia dhe zbardh ngjarjen e rëndë: Ja çfarë gjetëm në vendngjarje!




Dalin përgjigjet e 29 tamponëve që u morën në shkollën 9-vjeçare në Tiranë, ja sa mësues rezultuan të infektuar me COVID-19




Përkeqësohet shëndeti naftëtarëve në Ballsh, i bëjnë apelin urgjent ministres Spiropali dhe ambasadores Yuri Kim




Ministri Dendias vjen nesër në Tiranë, profesor Shaban Murati kap detajin dhe i drejtohet qeverisë shqiptare me thirrjen e rëndësishme: BE-ja nuk njeh pretendimet e Greqisë për...




Gara për hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit, 403 kandidatët vendosen sot përballë ‘sfidës së madhe’ për një vend në FB-në shqiptare (Detajet si do procedohet)



A duhet t’iu bëhet autopsy viktimave të Covid? Çfarë thotë mjeku epidemiolog i njohur shqiptar: Ne kemi me mijëra e mijëra të vdekur...



Rezultojnë të infektuar punonjës institucionesh, 38 raste me Covid-19 vetëm orët e fundit në këtë qytet të vendit, ndërsa në Elbasan mbyllet Gjykata



Polici e penalizoi se nuk kishte maskë, qytetari në Vlorë lë deklaratën perlë në fletën e gjobës (Ja fotoja që po qarkullon me shpejtësi në rrjetet sociale)

Mesazhe Promocionale

Gossip



■ ■ ■ ■ ■ ■

Moderatorja Arbana Osmani dhe Eduard Grishaj bëhen me djalë (FOTO)

Pritjes së ëmbël i erdhi fundi! Moderatorja e dashur Arbana Osm...

Opinione

RAMAZAN SHERJA
Femra duhet ta meritojë vlerësimin, jo t'i jepe...

FATOS ÇOÇOLI
Nafta pa taksa

PROF. DR. BARDHYL ÇIPI
Covid-19 krahasuar me HIV/AIDS në vendin tonë

BARDHYL BEJKO
Balloja e maskave në të vërtetë si revolucion n...

LEXO OPINIONE TE TJERA